



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

**VENDIM**

**Nr. 227, dt. 13.09.2016**


Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 13.09.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratohet projekti “Plotësimi, unifikimi dhe arredimi urban i rrugës “13 Dhjetori”, “28 Nëntori” dhe “Kol Idromeno”, Shkodër, me subjekt aplikues AADF.
2. Miratohet projekti për unifikimin e fasadës së pallatit në hyrje të rrugës “13 Dhjetori”, Shkodër, me subjekt aplikues AADF, me vërejtjet e mëposhtme:
  - *Unifikimi të bëhet me anë të strehëve tip tende sipas modelit të propozuar në pikën 1 të këtij vendimi.*
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**



**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**